

RREGULLAT E PROMOCIONIT "SAMSUNG GALAXY Z FOLD4 / Z FLIP4"

Data e publikimit dhe e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave: 10.08.2022.

Përpara se të blini pajisjen Samsung Galaxy Z Fold4 ose Z Flip4, ju lutem lexoni Kushtet dhe Afatet e Porositjes Paraprake (në vijim referuar si "**Rregullat**"):

1. Organizatori i Promocionit

Samsung Electronics Austria GmbH, me seli në Vjenë në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri dhe regjistruar me numër regjistrimi FN 217924b (në vijim referuar si "**Samsung**"), organizon porositjen paraprake të pajisjeve Samsung Galaxy Z Fold4 dhe Z Flip4 (në vijim veçmas "**Pajisja**" dhe bashkërisht "**Pajisjet**").

2. Periudha e promocionit dhe pjesëmarrësit

Porositja paraprake e pajisjeve Samsung Galaxy Z Fold4 dhe Z Flip4 është E disponueshme për blerësit privatë dhe biznes në territorin e Republikës së Kosovës që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këto Rregulla.

Kohëzgjatja e promocionit ("**Periudha promovionale**") për Pajisjet është nga data 10.08.2022 deri në 25.08.2022.

3. Përfitimet nga Promocioni

Blerësit privatë dhe biznes të cilët, gjatë periudhës së Promocionit, blejnë një prej Pajisjeve pranë partnerëve të shitjes së Samsung të listuar në këto Rregulla, do të kenë të drejtë të përfitojnë ulje çmimi në kohën e blerjes së Pajisjes, gjatë Periudhës së Promocionit pranë partnerit të shitjes Samsung, për shumën 200 Euro për Galaxy Z Fold4 dhe 150 Euro për Galaxy Z Flip4.

Zbritjet e mësipërme llogariten mbi çmimin e rregullt me pakicë të Pajisjes, i cili përcaktohet në mënyrë të pavarur nga secili partner i shitjes. Blerësit mund të mësojnë çmimin që aplikohet gjatë promocionit special të shitjes dhe çmimin më të ulët në periudhën prej tridhjetë ditësh përpara zbatimit të promocionit special të shitjes për çdo Pajisje individuale që është objekt i këtij promocioni në pikën e shitjes të një partneri individual të shitjes.

Përveç zbritjeve të përmendura për blerjen e Pajisjes, blerësit e Pajisjes mund të përfitojnë edhe një përfitim shtesë të mbrojtjes për ekranin e brendshëm të pajisjes së blerë, i cili mbulon një dëmtim të shkaktuar në ekranin e brendshëm të Pajisjes brenda vitit të parë nga momenti i blerjes së pajisjes së re, me kushtin e regjistrimit paraprak.

4. Kushtet për përfitimin e të drejtave nga Promocioni

Është i mundur fitimi i të drejtave nga Promocioni për blerësit e Pajisjeve, me kusht përmbushjen në mënyrë kumulative të kushteve vijuese:

- Blerësi porosit Pajisjen gjatë periudhës së Promocionit përcaktuar në pikën 2 të këtyre Rregullave;
- Pajisja porositet në faqen web të partnerit të autorizuar të shitjeve të Samsung në territorin e Republikës së Kosovës; Lista e partnerëve të autorizuar përcaktohet në pikën 5 të kësaj Rregulloreje;
- Blerësi porosit/blen pajisjen si përdorues fundor; Përdoruesit fundorë janë personat fizik ose juridik në territorin e Republikës së Kosovës të cilët kanë porositur/blerë pajisjen për qëllimet e tyre vetjake dhe jo me qëllim shitjen apo shpërndarjen e mëtejshme.
- Pas blerjes së një pajisjeje Samsung Galaxy Z Flip4 ose Samsung Galaxy Z Fold4 nga një prej partnerëve të shitjes të përmendur në pikën 5 të këtyre Rregullave, duke u regjistruar në faqen

www.partumglobal.eu, blerësi i Pajisjes mund të fitojë të drejtën e mbrojtjes së ekranit të brendshëm të Pajisjes së blerë nga dëmtimi, gjatë vitit të parë nga blerja e Pajisjes.

Në mënyrë që blerësi i Pajisjes të fitojë të drejtën e mbrojtjes së ekranit të brendshëm të Pajisjes kundër dëmtimit, klienti duhet të kryejë regjistrimin në <https://partumglobal.eu/xk/> brenda një maksimumi prej 14 ditësh nga dorëzimi i Pajisjes që është objekt i këtij promovimi, për klientin, me paraqitjen e detyrueshme të provës që Pajisja është blerë gjatë periudhës promovionale përcaktuar në pikën 2 të këtyre Rregullave tek një nga partnerët e shitjes përcaktuar në pikën 5 e këtyre Rregullave.

Në rast të shfrytëzimit të së drejtës nga mbrojtja e lartpërmendur kundër dëmtimit të ekranit të brendshëm të Pajisjes, përdoruesi i mbrojtjes është i detyruar të paguajë pjesën e tij të vlerës së dëmit, në shumën prej 109,00 Euro për Samsung Galaxy Z Flip4, ose 130,00 Euro për Samsung Galaxy Z Fold4.

Kushtet e mbrojtjes ndaj dëmtimit të ekranit të brendshëm të Pajisjes, kushtet e regjistrimit për mbrojtjen në fjalë, si dhe kushtet e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, përcaktohen në mënyrë të pavarur nga ofruesi i mbrojtjes. Blerësit e pajisjes mund të gjejnë informacion për sa më sipër në: <https://partumglobal.eu/xk/>

5. Partnerët e Autorizuar të shitjeve Samsung

- Neptun Kosova SH.P.K
- WishByTech SH.P.K
- Aztech SH. P.K.
- Gjirafa SH. P.K.

6. Dorëzimi i pajisjeve të blera

Pajisjet që janë objekt i këtij promovimi dhe që janë blerë gjatë periudhës së këtij promovimi, e në përputhje me rregullat e këtij promovimi, do t'u dorëzohen blerësve nga partnerët e shitjeve të Samsung nga të cilët janë blerë. Afati, koha dhe mënyra e dorëzimit të Pajisjeve të blera përcaktohen në mënyrë të pavarur nga partnerët e shitjeve të Samsung.

7. E drejta e ndryshimit të kushteve të promovimit

Samsung rezervon të drejtën të ndryshojë këto Rregulla në çdo kohë, për arsye të justifikuara, me detyrimin që t'i publikojë pa vonesë.